FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

# LANATOZID C

Tretësirë për injeksion – 0.4 mg / 2 ml (0.02%)
*(Lanatozid C)*

**Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.**
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

**Në këtë fletëudhëzues:**
1. Çfarë është Lanatozid C dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Lanatozid C
3. Si ta merrni Lanatozid C
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Lanatozid C
6. Informacion i mëtejshëm

## 1. ÇFARË ËSHTË LANATOZID C DHE PËRSE PËRDORET

Lanatozidi C është një glikozid kardiak me veprim inotrop pozitiv. Efektet e tij janë të ngjashme me digoksinën. Ai rrit forcën e tkurrjes së miokardit dhe ul përçueshmërinë e zemrës, sidomos përçimin përmes nyjes atrioventrikulare (AV). Lanatozidi C ushtron efekte inotrope pozitive dhe kronotrope negative.
Rreth 20% e dozës së përdorur çaktivohet brenda ditës. Efektet e tij zhduken pas 3 – 6 ditësh. Digoksina është metaboliti i lanatozidit C e që jashtëqitet përmes urinës.

**Lanatozid C indikohet në:**
- trajtimin e dekompensimit të lehtë dhe mesatarisht të rëndë të zemrës;
- trajtimin e takikardisë paroksizmale supraventrikulare.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Lanatozid C për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Lanatozid C.

## 2. PËRPARA SE TË MERRNI LANATOZID C

**Mos merrni Lanatozid C në qoftë se keni:**
- alergji ndaj lanatozidit C (fenomen i rrallë), glikozideve të tjerë, ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të formulës;
- dyshim për mbidozim të digitalit (përpara injektimit të barit, duhet të jeni të sigurt që jo vetëm gjatë kohës, por edhe 1-2 javë më parë ju nuk keni përdorur barna digitalike, qoftë edhe me doza të vogla);
- mbidozim të digitalit;
- çrregullime të përçimit të llojeve të ndryshme;
- sindrom të sinusit të sëmurë;
- fibrilacion ventrikular;
- kardiomiopati obstruktive hipertrofike;
- infarkt akut miokardi;
- sindromin Wolff-Parkinson-White, sidomos kur është i shoqëruar me fibrilim atrial.

Digitalikët duhet të ndërpriten në të sëmurët që përgatiten për goditjen elektrike.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, këshillohuni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

**Tregoni kujdes të veçantë me Lanatozid C**
Lanatozid C duhet përdorur me kujdes në bllokun e zemrës. Nëse lanatozidi C dhe glikozidet e tjera kardiake përdoren në bllokun e pjesshëm të zemrës, ato mund të nxisin një bllok të plotë të saj.
Kujdes duhet treguar edhe në të sëmurët me kardit reumatik.
Çrregullimet elektrolitike mund të ndikojnë në ndjeshmërinë ndaj digitalikëve. Efektet e tyre theksohen nga: hipokalemia, hipomagnezemia, hiperkalçemia, hipoksia dhe hipotiroidizmi. Në raste të tilla, doza e digitalikut duhet të reduktohet derisa këto gjendje të korrigjohen.
Doza dhe nivelet e Lanatozid C në plazëm duhen kontrolluar tek pacientët me funksion renal të dëmtuar, tek të moshuarit dhe fëmijët.
Gjatë përdorimit të digitalikëve, duhet bërë shumë kujdes për shfaqjen e shenjave të helmimit prej tyre, pasi janë barna me diapazon të ngushtë terapeutik.

**Marrja e barnave të tjera**
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Lanatozid C. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Lanatozid C në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Në të sëmurët që po mjekohen me doza mbajtëse të një glikozidi, injektimi në venë i një glikozidi tjetër me veprim të shpejtë shkakton helmim të rëndë.
Në të sëmurët që mjekohen me Lanatozid C, injektimi në venë i simpatomimetikëve apo i preparateve të kalçiumit, rrezikon jetën pasi mund të shkaktojë aritmi të rënda.
Barnat që shkaktojnë çrregullime të elektrolitëve e shtojnë rrezikun e helmueshmërisë së lanatozidit C dhe të glikozideve kardiotonike në përgjithësi.
Diuretikët tiazidikë dhe ata të ansës shkaktojnë hipokalemi dhe hipomagnezemi, çka mund të shkaktojë aritmi kardiake.
Shkaqe të tjera të hipokalemisë janë: mjekimi me kortikosteroide, amfotericinë, rrëshira jonokëmbyese, karbenoksolon dhe dializa.
Përqëndrimet në serum të lanatozidit C mund të rriten shumë nga kinidina, amiodaroni dhe propafenoni.
Kalçibllokuesit mund t'i rrisin përqëndrimet e lanatozidit C.
Propranololi, verapamili dhe rezerpina kanë efekt sinergjik me veprimin kronotrop dhe dromotrop të lanatozidit C.
Barbituratet, fenilbutazoni, antihistaminikët, fenitoina dhe hipoglicemiantët oralë shtojnë metabolizmin e lanatozidit C duke pakësuar efektin e tij.
Kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit nëse njëkohësisht me Lanatozid C merrni edhe barnat e përmendura më sipër.

**Marrja e Lanatozid C me ushqim dhe pije**
Nuk aplikohet.

**Shtatzënia dhe ushqimi me gji**
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë ose nëse jeni duke ushqyer foshnjen me qumësht gjiri.
Duhet të evitohet përdorimi gjatë kësaj periudhe.

**Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive**
Nuk ka të dhëna.

## 3. SI TA MERRNI LANATOZID C

Gjithmonë merreni Lanatozid C sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj. Në qoftë se ndjeni që efektet e Lanatozid C janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Përpara injektimit në venë tretësira e ampulës hollohet duke e bashkuar me tretësirë fiziologjike ose glukozë dhe aplikohet në venë ngadalë.
Doza e ngopjes së ngadalshme në dekompensimet e formave të rënda është 0.4 – 0.8 mg (1-2 ampula) që injektohen në venë për 7 – 10 ditë, kurse në ngopjen mesatarisht të shpejtë injektohen në venë 0.8 – 1.2 mg (2-3 ampula) për 3 – 5 ditë.
Pas arritjes së efektit terapeutik kalohet në dozat mbajtëse.
Kjo dozë është 0.2 – 0.4 mg (1/2 deri 1 ampulë) në ditë, që injektohet në venë.
Doza maksimale e njëhershme është 0.8 mg, kurse doza maksimale ditore është 1.6 mg.
Fëmijët: doza e ngopjes është 0.008 – 0.016 mg/kg peshë.

Mjeku juaj mund t'ju kërkojë të merrni Lanatozid C për një kohë më të gjatë. Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni i sigurt për sa kohë duhet ta merrni.

**Në qoftë se keni marrë më shumë Lanatozid C**
Marrja e dozave më të larta se ato të rekomanduara mund të çojë në helmim nga lanatozidi C.
Në qoftë se keni marrë më shumë Lanatozid C se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Simptomat e mbidozimit të Lanatozid C janë: të përziera, të vjella, anoreksi, diarre, dhimbje koke, lodhje, dobësi, marrje mendsh, përgjumje, konfuzion mendor, ëndrra të këqia dhe më rrallë delir, psikoza akute dhe haluçinacione.

**Në qoftë se keni harruar të merrni Lanatozid C**
Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar!
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo.

Lanatozid C dhe glikozidet e tjera kardiake mund të japin efekte të padëshirueshme sepse diapazoni midis dozave terapeutike dhe atyre helmuese është i vogël dhe kjo mund të bëhet shkak edhe për përfundime fatale. Helmimi është efekti anësor më i zakonshëm, i cili shfaqet me shenja të përgjithshme, shenja kardiake, gastrointestinale dhe neurologjike. Shenjat kardiake mund të shfaqen me rëndim të shkallës së insufiçiencës kardiake, bradikardi sinusale, blloqe të përçimit AV. Karakteristike për helmimin digitalik është takikardia atriale paroksizmale me bllok.

Në aparatin tretës vërehen të përziera, të vjella, anoreksi, diarre.

Në SNQ shfaqet: dhimbje koke, lodhje, dobësi, marrje mendsh, përgjumje, konfuzion mendor, ëndrra të këqia dhe më rrallë delir, psikoza akute dhe haluçinacione.

Mund të shfaqen reaksione mbindjeshmërie të shprehura me purpura trombocitopenike, rash makulopapular, gjinekomasti.
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të përmendura më sipër ju shqetëson.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 5. SI TA RUANI LANATOZID C

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Lanatozid C pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia!

## 6. INFORMACION I MËTEJSHËM

**Çfarë përmban Lanatozid C – Tretësirë për injeksion**
**Lënda vepruese** është lanatozid C.
Çdo ampulë 2 ml përmban 0.4 mg lanatozid C.
**Përbërësit e tjerë** janë: alkool etilik, glicerinë, acid klorhidrik mund të shtohet për rregullim pH, ujë për injeksion.

**Përmbajtja e paketimit**
Kuti me 10 ampula dhe kuti me 100 ampula (përdorim spitalor).

**Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:**

Sipas recetës së mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Tretësirë për injeksion.

**Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:**

**PROFARMA Sh.a.**
Rruga "Myslym Keta"
Tel.Fax. 00 355 4 23 62 800
Tiranë - SHQIPËRI

**Ky fletëudhëzues u formulua për herë të fundit në Nëntor 2010.**

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

**PAY ATENTION**, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.